

Blerta Xhako

Mban pozicion e Drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike pranë Zyrës së Komisionerit. Është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 2011. Znj. Xhako është licencuar në profesionin e avokatit prej vitit 2013 pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Në karrierën e saj ka ushtruar profesionin e avokatit, koordinatorit në Kryeministri dhe së fundmi ka mbajtur postin e Drejtorit të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administratën Publike pranë Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike. Znj. Xhako ka kryer disa trajnime brenda dhe jashtë vendit në fushën e jurisprudencës, si dhe të menaxhimit në administratën publike, certifikuar dhe nga shkolla e administratës publike franceze “Ecole Nationale D’Administration”.